

Arlindë KOTORRI

PROZA TREGIMTARE E KIM MEHMETIT

UDC 821.18.09

Abstrakti: *Kim Mehmeti është njëri prej më të veçantëve shkrimtarë të letërsisë shqipe në përgjithësi, siç edhe letërsisë shqipe në Maqedoni. Ai është i njohur si romansier, tregimtar, eseist, përkthyes e publicist, porse zhanri për të cilin ai shquhet në mënyrë të veçantë është tregimtaria. Si tregimtar, nis të shkruajë e të botojë në vitet '80-'90, për të vijuar deri në ditë e sotme. Veçojmë librat me tregime: "Pluhuri që mbin", "Dënesje", "Bolero", "Vdekja e magjistarës", "Lulehëna" etj.*

Fjalët kyçe: *Kim Mehmeti, letërsia shqipe, proza*

Letërsia shqipe e autorëve që kanë lindur ose edhe që jetojnë e krijojnë brenda territorit të Republikës së Maqedonisë, i ka shënjeshtër që identifikojnë tiparet e veçanta të saj në kuptimin e përzgjedhjes së temave dhe të formës rrëfimtare, një konfigurim kuptimplotë që përbën dhe risinë dhe po aq jep portretin e plotë të letërsisë shqipe, në mënyrë të veçantë të letërsisë bashkëkohore shqipe. Themi të letërsisë bashkëkohore, sepse letërsia shqipe e autorëve nga Maqedonia gjeti strehën letrare të fuqishme tek në vitet '70 të shekullit e XX e tutje gjer më sot.

Kjo pjesë e letërsisë shqipe u bë shumë e njohur për të tërhequr vëmendjen e kritikës po aq dhe të lexuesve, me emrat e mirënjohur të shkrimtarëve, siç janë: Luan Starova, Resul Shabani, Murat Isaku, Abdylaziz Islami, Adem Gajtani, Agim Vinca, Eqrem Basha, Nehat Sopaj, Kim Mehmeti etj.

Dhe, ky i fundit, pra Kim Mehmeti, për të cilin do të flasim, mund të themi se është njëri prej më të veçantëve shkrimtarë të letërsisë shqipe në përgjithësi, siç edhe letërsisë shqipe në Maqedoni.

Kim Mehmeti është i njohur si romansier, tregimtar, eseist, përkthyes e publicist, porse zhanri për të cilin ai shquhet në mënyrë të veçantë është tregimtaria. Si tregimtar, nis të shkruajë e të botojë në vitet '80-'90, për të vijuar deri në ditë e sotme. Veçojmë librat me tregime: "Pluhuri që mbin", "Dënesje", "Bolero", "Vdekja e magjistarës", "Lulehëna" etj.

Kim Mehmeti që në librat e parë në fushë të prozës tregimtare, ka rënë në sy të kritikës dhe të lexuesve për botën e veçantë fikzionale, përkatësisht realitetet e çuditshme që trajtojnë tregimet e tij. Duke pasur një vërtetim shumë të ndjeshëm për të vërtetat e realiteteve dhe për realitetet e imagjinuara, si pjesë të rrëfimit, Kim Mehmeti do të bëhet i njohur si autor që ia kthen shpinën në mënyrë të hapur realizmit formal dhe rroket pas formave tregimtare të realizmit magjik, ndaj të cilit realitet do të jetë koherent nga vepra e parë deri te ajo e fundit.

Për prozën tregimtare të Kim Mehmetit do të shkruhen një mori tekstesh recensionale, eseistike, si dhe studime. Vepra e tij do të jetë objekt leximesh e analizash që synojnë për të interpretuar e zbuluar të fshehtat e realiteteve të temave e të formave rrëfimtare. Kam në vëmendje këtu mendimin e kritikës letrare të Kosovës të autorëve brezash të ndryshëm, si: Ali Aliu, Ramadan Musliu, Kujtim Rrahmani, Fazli Gajraku etj., të cilët janë marrë me veprën tregimtare të Kim Mehmetit.

Titulli i temës sonë "Proza tregimtare e Kim Mehmetit", i referohet idesë për të veçuar disa nga tiparet e

tregimit të këtij autori në rrafshin tematik dhe të formës narrative, që realizohen të ndërthurura nga veçori të realitetit e të mitit, të besimit e të besëtytnisë, të jetës që zbulon të vërtetat e një realiteti e të një ambienti oriental dhe të një tjetri që vjen nga oksidentalja, si një tjetër kulturë e sjellje.

Kim Mehmeti, për t'i zbuluar këto realitete me një fantazi krijuese, kërkon forma e teknika narrative, nëpërmjet të të cilave do të shfaqet e do të bëhet i njohur si autor që ofron modelin e vet të rrëfimit dhe që është një hetim që kërkon originalitetin, dhe që nuk pajtohet me format e tregimit konvencional.

Duke përcjellë me vëmendje prozën tregimtare të këtij autori, hetohen ndryshimet që lidhen me mënyrën se si autori afrohet apo largohet nga të vërtetat e realiteteve, nëpërmjet formave narrative që zgjedh. Me këtë rast, janë të vërejtshme në përmbledhjet me tregime “*Bolero*” (1991) dhe “*Lulehëna*” (1997) format kërkimit dhe tendencat pas realiteteve e formave rrëfimtare që pasurojnë tregimin.

Pra, në realitetet e tregimeve vijnë rrëfyes e personazhe që njëherë janë të lidhur me besëtytni që vjen nga një fryme orientale e jetës, formë kjo e botëkuptimit ku jeta është e lidhur sa me frikën, po aq edhe me shpëtimin nga fuqia mbinatyrore e cila gjendet në shpirtin e njeriut (shih tregimet *Bolero*), më pas kemi një shpëputje nga ky realitet tematik, duke u lidhur fuqishëm me idenë eseistike të rrëfimit dhe po aq të një realiteti ekzistencial të jetës në rrjedhën e kohës e të një ambienti e realiteti nacional, ku simboli e metafora bëhen qëllim më vete të tregimit.

Pra, në fillimet e krijimtarisë tregimtare, (kemi parasysh këtu librin me tregime *Bolero*), autori është i përqendruar të rrëfejë për format besëtyte të jetës të jetuara e të përjetuara fuqishëm nga personazhet. Personazhi, që është njëkohësisht edhe rrëfimtari, gjatë gjithë kohës është i hutuar e trembur, duke parë e dëgjuar fuqinë çudibërëse të magjistares Fatkë. Fatka parandien të mirën ose të keqen që na vjen në jetë dhe këtë e zbulojmë nga vetërrëfimtari personazh, i cili thotë:

*“Magjistaren Fatkë e mbaj mend që nga ditët e hershme të fëmijërisë. U rrita në prehrin e saj. Më donte për së tepërmi ajo plakë e çuditshme...”*¹

Pra, kemi një rrëfimtari i cili, përveç që ka njohje dhe jeton pranë realiteteve të kësaj magjistareje, ai ka ndjenja të fuqishme për të e është deri në dorëzim me të, sepse është ajo që atij mund t’ia lexojë mendjen e t’ia përcaktojë fatin. Rrëfimi i Fatkës ose rrëfimi për Fatkën, bartet nga tregimi në tregim dhe lidhja dhe raporti i rrëfimtari me të, bëhet i ndryshueshëm. Ai herë do të gjendet pranë, herë do të dëgjojë rrëfimet për të; herë do të njohë e kuptojë fuqinë shpirtërore fisnike të saj e herë do të dyshojë në të.

*“Kur disa udhëtarë pohojnë se shtëpia e Fatkës tani është mbushur përplot me minj, të cilët brejnë njëri-tjetrin, unë vetëm buzëqesh, sepse e di se ata minj janë të dërguarit e Fatkës dhe se ajo nëpërmjet tyre, tallet me njerëzit”*².

Në këtë realitet narrativ, për Fatkën do të kuptojmë si për një qenie që jeton me vdekjen dhe me pavdekësinë, me fuqinë e saj shëruese po aq dhe me fuqinë e saj shkatërruese. Ajo herë është përballë fuqisë së natyrës për ta mundur atë, herë ndjehet të jetë e mundur.

*“Shumë herë në orët e vona të natës, kur paraqitej hëna në qiellin e kaltër përplot me yje, Fatka shihet t’i përziante lëngjet nga të cilat bënte ilaçe të ndryshme...”*³

Sipas mendimit të studiuesit Kujtim Rrahmani, kjo lojë e realiteteve ku konfrontohet realja me irrealen “entitetin e vet tematik e gjejnë te prirja për asimilimin e mitit, ritualit orientalo-okcidental

¹ Kim Mehmeti, *Bolero*, Rilindja, Prishtinë, 1991, f. 5.

²Po aty, f. 62.

³Po aty, f. 62.

dhe folklorit, me traditën e prosedeut realmagjik¹. Këtë e vërtetojnë realitetet që jetohen dhe përjetohen herë si dëshmi të jetës që vijnë nga ambiente të kulturës orientale, si: *Medina ose Meka*, ose personazhe të këtij ambienti si: *Ymreja*, *Adumi* etj., ose fakte, dëshmi e personazhe që identifikohen si pjesë të kulturës nacionale, si: *Adelina*, *Emali*, *Jetëmira*, *Nora* etj.

Ky qëndrim ndaj realitetit që vjen nga kultura besëtyte e jetës, që lidhet me magjinë e të magjishmen do të ndryshojë në librin me tregime *Lulehëna* (1997). Në këtë përmbledhje me tregime, kemi paraqitjen e një realiteti që zgjerohet e thellohet në format simbolike të shprehjes, me vetëdijen e braktisjes së një realiteti të përqendruar në kuptimin figurativ e asociativ në temën e mitit e të riteve e ritualeve që vijnë e ruhen nga format e hershme të jetës.

*Frikën duhet ta flakni që tani nga vetvetja, jo pse më keni pranë mua, por për shkak se ajo është pjesë e reliefit të padukshëm të asaj rruge.*²

Te *Lulehëna*, kemi rrëfimtari që zbulohet vetë dhe për aq sa rrëfen realitetin flet dhe i drejtohet edhe lexuesit. Pra, pozicioni i tij është pozicion i vetë autorit, që komunikon herë me ndjenjën e rrëfimitarit e herë të një autori që ka parasysh lexuesin dhe flet me të me vetëdijen e një shkrimtari përballë lexuesit të vet. Në këtë rrethanë ai, të te përmbledhja me tregime *Lulehëna*, e bën të dukshëm gjithë historinë e rrëfimeve të tij e të lidhjes me personazhet e realitetet e këtyre rrëfimeve.

*Është pak të them se u shtanga nga jehona e zërit të dashur. Pak është të them se ai zë luhati boshtin mbi të cilin qëndronin bindjet e mia të thella se komunikimi me Fatushën kishte marrë fund përgjithmonë, përveç nëse nuk i llogarisja pëshpëritjet që vite me radhë ia drejtoja hijes së saj, që më shoqëronte kudo që të isha. “Fatushë, ende vallë të mundon etja?” - pyeta duke mos ditur me kë bisedoja. Dhe në atë çast m’u bë se era ndërroi drejtimin, se dikush qëndronte pranë meje dhe më shikonte vëngër. Po, po, Fatushja e para njëzet vitesh e bartur nga era qëndronte pezull mbi mua, jo si hije, por si bukuri, e dashur dhe e largët.*³

Pra, siç vërehet, në tregimet *Lulehëna*, ai zbulon gjithë konceptin krijues të tij prej shkrimtari (tregimtari) përmes një forme të të folurit hapur – pa kurrfarë ngurrimi, për historinë e rrëfimeve të tij. Kështu, autori na lejon mundësi që atë ta përcjellim jo vetëm përmes formës tregimtare, të shoqërohemi me atë rrëfim, të jetojmë brenda tij me gjithë ndjesinë tonë, por edhe përmes pikëpamjeve të tij estetiko-letrare në formë të drejtpërdrejtë që i jep nëpërmjet pozicionit të tij rrëfyes të veçantë.

Krejt në fund, të theksojmë se nëse në librin me tregime *Bolero* (1991), rrëfimi bënte jetën e vet në universin e botës magjike e të realiteteve besëtyte, në librin *Lulehëna* (1997), përforcohet diskursi eseistik e bashke me të edhe format simbolike e ironike të rrëfimit.

Pra, tregimet e librit *Lulehëna* janë si një antipod i atyre të librit *Bolero*, në kuptimin e prejardhjes së realitetit e të lojës me fiksionin, si dhe të formës e diskursit narrativ.

¹ Kujtim Rrahmani, *Gramatika e fshehtë e motiveve*, Qendra e Kulturës, Podujevë, 1998, f. 96.

² Kim Mehmeti, *Lulehëna*, Dukagjini, Pejë, 1997, f. 27.

³ Po aty, ff. 106-107.

Bibliografia

Ali Aliu, *Reflekse letrare* Flaka, Shkup, 1999.

Ali Aliu, *Dëshmi letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2008.

Ali Aliu, *Kënaqësia e leximit*, ASHAK, Prishtinë, 2012.

Fazli Gajraku, *Utopia e narracionit*, AIKD, Prishtinë, 2008

Kujtim, *Gramatika e fshehtë e motiveve*, Qendra e Kulturës, Podujevë, 1998

Mehmeti, Kim, *Vdekja e magjistarës*, parathënia e RamadanMusliut, ShB e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1994

Mehmeti, Kim, *Bolero*, Rilindja, Prishtinë, 1991

Mehmeti, Kim, *Lulehëna*, Dukagjini, Pejë, 1997